

Prof. dr. Izber Hoti

## LËVIZJA KAÇAKE NË PRISHTINË DHE RRETHINË MBËSHTETUR NË DOKUMENTET SERBE

**P**ushtimi, shtypja nacionale si dhe pakënaqësia e llojllojshme ndaj pushtetit të ri (Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene -SKS) janë burimet kryesore të Lëvizjes Kaçake në Kosovë, pra edhe në rrethin e atëhershëm të Graçanicës, për afërsisht Prishtinës dhe rrethit të sotshme. Luftë të armatosur dhe njerëz me armë në dorë, që pushtuesit serbë pothuajse përherë i cilësojnë si kaçakë, në këtë rrethinë pati edhe në kohën e Perandorisë Osmane dhe pas Luftës së Parë Ballkanike, mirëpo numri i tyre shtohet dukshëm pas vitit 1918, veçanërisht në vitet 1918 – 1924.

Pakënaqësia ndaj ripushtimit të kësaj treve nga Serbia shtohet edhe për shkaqe të tjera. Vend të posaçëm në këtë aspekt ka ndikimi i Reformës Agrare, korrupsioni i organeve qeveritare,<sup>1</sup> shtypja e përhershme për shpërnguljen e shqiptarëve, aksionet e çetnikëve të Kosta Peçancit kundër shqiptarëve, veçanërisht gjatë vitit 1919, etj.<sup>2</sup>

1. Arkivi Institutit Ushtarak i Historisë, Beograd (më tej AIUH), regjistri (r.) 4/3, fashikulli (f.) nr. 5, dokumenti (dok.) nr. 12/99.

2. AIUH, r. nr. 4/3, kutia nr. 54, dok. 1/62 (Po këto të dhëna pohohen në

Që në fillim të vitit të parë të sundimit të Mbretërisë SKS, qarku i Kosovës, rrethi i Graçanicës (tash përfaqësohet Prishtina me rrethinë) konsideroheshin si qarqet më të trazuara në Kosovë. Kundërvënia e përgjithshme popullsisë së kësaj ane në dokumentet zyrtare dhe ushtarake vlerësohej si Kryengritje e Përgjithshme shqiptare, apo më saktë "Kryengritja e Drenicës", e cila pati jehonë edhe në këtë rrethinë, madje përfshiu edhe një pjesë të saj. Për këtë arsye në tetor të vitit 1919 në Prishtinë dhe në rrethinë u ndërmorën masa efikase për shuarjen e kësaj kryengritje.<sup>3</sup>

Duhet shtuar që në fillim se në Prishtinë dhe rrethinë, përveç veprimtarisë së kaçakëve të këtij vendi dhe të kësaj ane, vepronin edhe kaçakët e Llapit dhe të Drenicës. Kështu sulmi i disa kaçakëve të Drenicës (prej më se 20 vetash) në fshatin Sllatinë, që atëherë ishte qendër komunale, si dhe e dhëna se populli po armatosej për t'u përgatitur për kryengritje, nxiti organet qeveritare të qarkut të Kosovës që të kërkonin shtimin dhe forcimin e xhandarmërisë, përkatësisht të policisë dhe të njësiteve të tjera ushtarake për të vepruar në mënyrë sa më të shpejt dhe më të pashpirt.<sup>4</sup>

Kah fundi i vitit 1919 organeve qeveritare të qarkut të Kosovës nuk u mjaftonin forcat e xhandarmërisë dhe ato të policisë, prandaj kërkonin përforcime ushtarake për të qetësuar popullsinë e kësaj rrethine, e cila nuk i bindej urdhrave të organeve shtetërore dhe ushtarake.<sup>5</sup>

---

Radničke novine, nr. 284, 2.XII.1919.

3. AIUH, r. 3/4, k. nr. 54, f. nr. 5, dok. nr. 12/113 dhe k. nr. 57, f. 7, dok. nr. 14/27.

4. AIUH, r. 3/4, k. nr. 45, f. nr. 2, dok. nr. 1/62.

5. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 45, f. nr. 12/19.

Duke parë shtimin e përhershëm të pakënaqësisë së popullsisë, si dhe shtimin gjithnjë e më të madh të kaçakëve të kësaj ane, edhe rrethi i Graçanicës në janar të vitit 1920 futet në kuadër të rretheve që duhej të çarmatosej.<sup>6</sup> Mirëpo, kjo nuk i pengoi aspak kaçakët që të sulmonin fshatin Sibovc afër Prishtinës.<sup>7</sup> Po në të njëjtën kohë pranë fshatit Vragoli ndodhi një përlëshje e armatosur ndërmjet xhandarëve dhe kaçakëve. Përlëshja zgjati më se 12 orë. U përlëshën një grup prej më se 15 kaçakësh dhe togu II i xhandarmërisë, siç thuhet në dokumentet shtetërore, dy togje të xhandarmërisë këmbësore, të ndihmuara nga një aradhë xhandarësh të Mitrovicës. Kjo përlëshje, data e së cilës për çudi nuk përmendet në këtë dokument, pati jehonë të madhe edhe jashtë Kosovës.<sup>8</sup>

Për të çarmatosur shqiptarët e rrethinës së Prishtinës, veprim ky që filloi më 11. III. 1920, morën pjesë tri çeta të Batalionit III të Regjimentit të 31-të me dy topa malorë dhe Bateria II Fushore, që duhej të arrinte në ndërkohë.<sup>9</sup>

Çarmatimi i kësaj ane u krye në fund të muajit mars të vitit 1920 dhe, sipas dokumenteve ushtarake, gjatë kësaj veprimtarie ndodhi *një incident* ndërmjet ushtrisë dhe popullsisë. Përndryshe, gjatë çarmatimit në rrethin e Graçanicës, përkatësisht, përafërsisht në rrethin e sotshëm të Prishtinës, u mblodhën 101 pushkë, 16 pistoleta të kalibrave dhe të llojeve të ndryshme, një bombë serbe dhe 700 plumba.<sup>10</sup>

6. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 63, f. nr. 7, dok. nr. 15/2.

7. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 63, f. nr. 7, dok. nr. 15/3.

8. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 58, f. nr. 1, dok. nr. 1/43.

9. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 63, f. nr. 7, dok. nr. 15/15.

10. Incidenti i ushtrisë dhe i popullsisë me këtë rast ndodhi në Gum-

Megjithatë, edhe sipas vlerësimeve të përgjegjësve të atëhershëm të forcave të armatosura, çarmatimi i shqiptarëve nuk u krye në tërësi.<sup>11</sup> Po në atë muaj veprimtaria e armatosur e Ramë Vllasës dhe e Sahit Shajkovcit ishte e dukshme. Pasi forcat e tyre duken në fshatin Prugovc organizohet menjëherë ndjekja, e cila ishte përgatitur që herët, por me këtë rast e forcuar me një çetë dhe dy mitraloza. Ndjekja e këtyre kaçakëve dhe e kaçakëve të tjerë, gjithnjë sipas dokumenteve ushtarake serbe, shkonte drejt fshatit Dyz, Sharban, Ballaban dhe Keçekollë.<sup>12</sup>

Pas veprimtarisë së shtuar të kaçakëve në Prishtinë dhe rrethinë komanda e Divizionit të Kosovës më 16. VI. 1920 urdhëroi sërish komandantin e Armatës III që ushtria dhe policia të organizonin së bashku ndjekjen, zënien dhe likuidimin e këtyre kaçakëve dhe të pasuesve të tyre, që në të vërtetë nënkuptonte çdo shqiptar që i kundërvihet Mbretërisë SKS, si dhe shqiptarët e tjerë që forcat e armatosura serbe i konsideronin sitërrezikshëm.<sup>13</sup> Megjithatë, veprimtaria e kaçakëve të kësaj ane vetëm rritej. Në qershor të vitit 1920 rrethi i Prishtinës vlonte nga pakënaqësia dhe koordinimi i rezistencës shqiptare sa vinte e shtohet,<sup>14</sup> ndërsa Çiçavica, Dobroshevcit e Çikatova ishin përplot kaçakë, ndikimi i të cilëve ndihej dhe shqetësonte edhe vetë kryeqendrën e këtij rrethi – Prishtinën.<sup>15</sup>

---

nasellë dhe në të humbi jetën Murat Shabani (AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 60, f. nr. 6, dok. nr. 12/17).

11. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 63, f. nr. 7, dok. nr. 15/36.

12. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 63, f. nr. 7, dok. nr. 15/12.

13. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 60, f. nr. 5, dok. nr. 12/17.

14. Këtë vlerësim bën edhe Ajet Haxhiu në veprën e tij Hasan Prishtina, Tiranë 1968, f. 233.

15. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 58, f. nr. 3, dok. nr. 1/173; AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 60, f. nr. 8, dok. nr. 12/235.

Në gusht të vitit 1920 në viset veriore të rrethit të atëhershëm të Graçanicës kundërvënia e masës së gjerë shqiptare ndaj shtypjes kombëtare mori përmasa edhe më të gjera. Në këtë kohë kundërvënia e kësaj ane dhe e anës së Podujevës, ndër qarqet e armatosura serbe u emërua si "Kryengritja e Llapit".<sup>16</sup> Si njëri ndër udhëheqësit e kësaj kryengritje përmendej edhe Xhemajl bej Prishtina nga Vushtrria.<sup>17</sup> Për ta shuar këtë kryengritje u bë mobilizimi i përgjithshëm ushtarak i Armatës III. Nën komandën e Radovan Radoviqit një batalion ushtarësh me dy topa dhe katër mitraloza zhduku nga faqja e dheut fshatin Prapashticë. Pothuaj kështu ndodhi edhe me fshtrat Koliq dhe Keçekollë.<sup>18</sup> Nga kjo ekspeditë ndëshkuese ushtarake pësoi edhe fshati Nishevc, por edhe popullsia e fshatrave përreth.<sup>19</sup>

Në fund të vitit 1920 në qarkun e atëhershëm të Kosovës nuk ndihmuan as ndjekjet, as ekspeditat ndëshkuese, as ushtrimi i frikës në forma të ndryshme, as likuidimi i kaçakëve dhe as internimi i familjeve të tyre. Numri i kaçakëve, gjithnjë sipas vlerësimeve të ushtarakëve dhe të organeve serbe, shtohet gjithnjë e më shumë e me këtë edhe numri i xhandarëve dhe i ushtarëve të vranë. Deri në këtë kohë në qarkun e Kosovës u vranë më se 50 xhandarë. Mu për këtë arsye ndihma e kërkuar nga Armata III për bashkëngjitje edhe të një regjimenti ushtarësh u miratua njëzëri nga ana e Gjeneral Shtabit në Shkup.<sup>20</sup>

16. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 60, f. nr. 7, dok. nr. 12/205 (Po kështu mendon edhe Djordje Krstić, në veprën Kolonizacija Južne Srbije, Sarajevë 1928, f. 95.)

17. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 60, f. nr. 6, dok. nr. 2/162.

18. Si shënimi 16.

19. Po aty.

20. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 62, f. nr. 10, dok. nr. 12/238 dhe dok. nr. 12/239.

Edhe në vitin 1921 numri i kaçakëve në listat e ashtuquajtura kriminele shtohet dhe pothuajse janë të vetmet krime të kohës. Kështu vetëm gjatë muajit janar të këtij viti pati 11 sulme e përleshje të armatosura kaçakësh. Në këtë kohë rreth Rusinovcit vepronte grupi i Idriz Aliut – Raçakut, ndërsa në Sllovinjë grupi i Idriz Xhamajlit nga Gumnasella.<sup>21</sup> Në një situatë të tillë hekurudha Kaçanik – Mitrovicë nuk ishte e sigurt, prandaj më 11. II. 1921 Gjeneral Shtabi në Shkup bëri rajonizimin e kësaj hekurudhe me synim që ajo të ruhej më mirë. Në këtë frymë edhe Prishtina kishte rajonin e vet të sigurimit, i cili fillonte nga Lipjani dhe përfundonte në Obiliq, në të cilin u vendos roja e përhershme.<sup>22</sup>

Në vitin 1923 me veprimtarinë e vet prej kaçaku në rrethin e Graçanicës, sipas po këtyre dokumenteve, shquhet grupi i Tahir Ukës, që vepronte në Keçekollë, në Prapashticë, si dhe në fshatrat e tjera të rrethinës së Prishtinës dhe të trevës së Gallapit. Duhet shtuar se numri i kaçakëve të kësaj ane ishte shumë më i madh dhe sipas këtyre të dhënave kjo nuk mbeti pa u vërejtur edhe nga organet shtetërore dhe ushtarake serbe.<sup>23</sup> Disa prej këtyre kaçakëve nga ana e pushtetit

21. Këto të dhëna pohohen edhe nga dokumentet e Arkivit Qendror Historik të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në Tiranë, fondi i Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, dosja nr. 13, dok. nr. 708416.

22. AIUH, r. nr. 4/3, k. nr. 60, f. nr. 2, dok. nr. 7/6.

23. Arkivi i Jugosllavisë në Beograd, 14 -141- 533.

Në regjistrin e kaçakëve sipas vendeve figurojnë këta emra: Radevë: Adem Raçaku, Jetush Behlul Budakova, Shaqir Lah Haziri (nga Sankoci) dhe Sokol Muharremi; Halilaq: Jakup dhe Emrush Uka; Keçekollë: Tahir Uka, Rexhep Neziri, Hajdin Ruhani, Arif Rama, Ymer Asllani dhe Ramë Pajaziti; Prapashticë: Nazif Ymeri, Hajrullah Zeneli, Nuredin Ymer Haxhiu dhe Halil Zeneli; Prishtinë: Ibush e Esat Vuçiterna, Mustafë Ymeri, Latif Bajrami, Bajram Tmava dhe Gjekush Bahtijari. (Po aty).

serb llogariteshin madje shumë të rrezikshëm dhe për denoncimin dhe kapjen e tyre ofroheshin shuma të konsiderueshme të hollash. Kështu më 1923 pushteti serb për zënien e Hajdin Ruhanit nga Keçkolla premtonte 2.000 dinarë të atëhershëm. Me shuma të ngjashme apo më të vogla të hollash denoncoheshin edhe kaçakë të tjerë të kësaj ane.<sup>24</sup>

Qarqet qeveritare dhe ushtarake serbe edhe në vitin 1924 u detyruan t'i kushtojnë kujdes të veçantë Lëvizjes Kaçake në Prishtinë dhe rrethinë. Ata u detyruan të pranonin se edhe në këtë kohë në këtë rreth, përkatësisht në rrethin si ata e quanin të Graçanicës, ka më se 20 kaçakë në zë. Ata jo vetëm që silleshin lirisht në malet e largëta të Prishtinës, siç shpreheshin zyrtarët serbë, por lirisht silleshin e madje edhe vepronin edhe në malet e Gërmisë.<sup>25</sup>

Pas vitit 1924 Lëvizja Kaçake në Prishtinë dhe rrethinë, si dhe në mbarë Kosovën, bie shkallë-shkallë. Në këtë mënyrë pas vitit 1927, përveç ndonjë organizimi të vogël, Lëvizja Kaçake ishte shuar e situata, siç vlerësonin organet pushtuese, ushtarake e shtetërore serbe, "ishte qetësuar".<sup>26</sup> Në këto rrethana ndërmjet dy luftërave botërore edhe në këtë anë kundërvënia ndaj pushtimit do të zhvillohej në forma dhe mënyrë të tjera të paarmatosura dhe ilegale.

24. Arkivi i Kosovës, Gjyqi i Shkallës së Parë në Prishtinë, dokumente të parregulluara (dokumentet e kohës me numër 1114/24, 370/23, 1172/36 dhe 67-95/1992).

25. Arkivi i Kosovës, fondi XXIX, k. nr. 1 (numri i dokumentit të kohës 16).

26. Arkivi i Kosovës, Gjyqi i Shkallës së Parë në Prishtinë, dokumente të parregulluara, dokumneti i datës 25.XI.1928.

